

Bazuar në pjesën 2.02 të Marrëveshjes së Projektit dhe Marrëveshjes së Grantit (Ndihmë Teknike) të lidhur ndërmjet Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor dhe Bankës Evropiane për Rindërtimin dhe Zhvillimin e projektit "Projekti Rajonal i Mbeturinave të Ngurta", i mbështetur nga Qeveria Suedeze, përmes SIDA- Llogaria e programit komunal për mjedis dhe klimë të BERZH II, me numër operimi 15338-116763 – 52828, dhe në bazë të Ligjit për huamarrje të Republikës së Maqedonisë së Veriut me kredi nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim "(Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 251/22), Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor zbaton:

**Thirrje publike për shprehje interesi për shërbime konsulence
për Projektin "Projekti Rajonal i Mbeturinave të Ngurta".**

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor ka filluar procedurën për punësimin e konsulentëve individualë për këto pozita:

- Inxhinier i mbeturinave të ngurta (SWE) – PE anëtar 2 (dy) përmbaues
- Specialist për furnizim publik - anëtar i PE 1 (një) përmbaues
- Specialisti i financës/disbursimit - anëtar i PE 1 (një) përmbaues

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor i fton të gjithë kandidatët që i plotësojnë kushtet të shprehin interes për ofrimin e shërbimeve këshilluese.

Kandidatët e interesuar duhet të japin informacione që konfirmojnë se posedojnë kualifikimet e nevojshme dhe përvojën përkatëse të punës për kryerjen e detyrave.

Nëse konsideroni se plotësoni kualifikimet dhe përvojën e duhur, Ju lutemi dorëzoni Biografinë tuaj Profesionale - CV-në, Letrën e Interesit dhe dokumentet për konfirmimin e kualifikimeve të nevojshme profesionale, me një tregues të qartë të pozicionit për të cilin po aplikoni në adresën e mëposhtme të emailit: A.Karanfilova@moepp.gov.mk dhe në arkivin e Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor.

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve është **26.07.2023 deri në orën 12:00** me orën lokale.

Përshkrimi i detajuar i vendeve të punës dhe kushteve të punës për pozitat për të cilat është publikuar ky konkurs gjenden më poshtë në Thirrjen Publike.

Kualifikimet dhe kushtet e nevojshme profesionale për nominimin dhe emërimin e anëtarëve të Njesisë së Projektit

Pozicioni 1:

Inxhinier i mbeturinave të ngurta (SWE)

Anëtar i PE 2 (dy ekzekutues) duhet t'i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Të ketë të përfunduar arsimin e lartë, me të paktën 240 kredite të fituara sipas ECTS ose të përfunduar shkallën VII/1 të fakulteteve teknike ose të shkencave natyrore;
- Të paktën 1 vit përvojë në menaxhimin e mbeturinave (infrastruktura e menaxhimit të mbeturinave (deponive, stacione transferimi etj.), pajisje për grumbullimin e mbeturinave, etj.);
- Njohuri aktive të gjuhës angleze;
- Të ketë njohuri të punës me kompjuterë MS Office.
- Që nuk i është ndaluar kryerja e një veprimtarie apo profesioni

Pozicioni 2:

Specialisti i furnizimeve publike - anëtar i PEI

1 (një) përmbaues duhet t'i plotësojë kushtet e mëposhtme:

- Të ketë të përfunduar arsimin e lartë, me të paktën 240 kredite të fituara sipas ECTS ose të përfunduar shkallën VII/1 në shkencat ekonomike dhe/ose juridike.
- Të paktën 1 vit përvojë pune në fushën e kontratave publike dhe furnizimit, posedimi i certifikatës së dhënies së provimit nga zyra e furnizimit publik do të konsiderohet përparësi;
- Njohja e rregullave të furnizimit të Institucioneve Financiare Ndërkombëtare (IFN) dhe kushteve të FIDIC do të konsiderohet si avantazh (me deklaratë);
- Njohuri aktive të gjuhës angleze;
- Të ketë njohuri të punës me kompjuterë MS Windows, Word, Excel, Internet, Power Point.
- Që nuk i është ndaluar kryerja e një veprimtarie apo profesioni

Pozicioni 3:

Specialist i Financave/ disbursimit Anëtar i PEI

1 (një) përmbaues duhet t'i plotësojë kushtet e mëposhtme:

- Të ketë të përfunduar arsimin e lartë, me të paktën 240 kredite të fituara sipas ECTS ose të përfunduar shkallën VII/1 të shkencave ekonomike;
- Të paktën 1 vit përvojë pune në fushën e financave;
- Njohuri aktive të gjuhës angleze;
- Të ketë njohuri të punës me kompjuterë MS Office.
- Që nuk i është ndaluar kryerja e një veprimtarie apo profesioni

Detyrat e parashikuara të anëtarëve të Njesisë së Projektit

- 1) Anëtarët e PEI-së ndihmojnë drejtuesin e PEI-së në realizimin e aktiviteteve të fushës së tij të punës dhe i japin mbështetje Udhëheqësit në përgatitjen e raporteve mujore, tremujore dhe vjetore për ecurinë e zbatimit të projektit dhe raportin përfundimtar për realizimin e projektit.
- 2) Anëtarët e PEI janë përgjegjës për t'i dhënë informacion në kohë Koordinatorit, me qëllim përmbushjen e plotë të aktiviteteve që lidhen me përgatitjen dhe zbatimin e projektit.
- 3) Anëtarët e PEI do të bashkëpunojnë me institucionet financiare, me konsulentë, do të punojnë për zbatimin e procedurave të tenderit, lidhjen dhe zbatimin e kontratës me kontraktorin.
- 4) Anëtarët e PEI, sipas nevojës, marrin pjesë në takime të rregullta për monitorimin e projektit dhe për të përgatitur shënime të shkurtra mbi to, si dhe organizojnë një vizitë në vendin e projektit nëse është e nevojshme.
- 5) Anëtarët e PEI-së janë përgjegjës para drejtuesit të PEI-së për kryerjen në kohë dhe cilësore të punës së tyre brenda autorizimeve dhe kompetencave të tyre.
- 6) Anëtarët e PEI kryejnë edhe detyra të tjera të ngarkuara nga udhëheqësi i PEI, në përputhje me marrëveshjet e nënshkruara në lidhje me zbatimin e projektit.
- 7) Anëtarët e PEI në punën e tyre respektojnë kërkesat për etikë dhe integritet në vendin e punës.
- 8) Anëtarët e PEI përgjigjen para udhëheqësit të PEI.